



Ne bazë të nenit 14 dhe nenit 58 pika a), b), d), g) i), të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 dhe në përputhje me nenin 6, 7 dhe 8 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtëshme të Komunës, dhe nenet 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Kapitullit III të Rregullores së QRK-së Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Palujtëshme të Komunës si dhe nenit 21 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.27.05.2015, bie këtë::

VENDIM

PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË (99) VITE TË TOKËS NDËRTIMORE KOMUNALE ME KONKURS PUBLIK

I.

Merret Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vite të tokës ndërtimore në pronësinë komunale me konkurs publik, me qëllim të ndërtimit të lartë në qytetin e Deçanit, i cili përfshinë ngastrat në vijim: ngastra nr. 1014 në sipërfaqe prej 1649 m², me kulturë ndërtesë dhe oborr, nr.1073/1 në sipërfaqe prej 4343 m² me kulturë oborr, nr.1096 në sipërfaqe prej 265 m² me kulturë ndërtesë, nr.1097 në sipërfaqe prej 140 m² me kulturë ndërtesë, nr.1098 në sipërfaqe prej 225 m² me kulturë ndërtesë, nr.1294/1 në sipërfaqe prej 2725 m² me kulturë ndërtesë dhe oborr, si dhe Ngastra nr.0941 në sipërfaqe 1083 m², me kulturë guri dhe, ngastra nr.0944 në sipërfaqe 62 m² me kulturë shtëpi ndërtesë, ngastra nr.1254-1, me sipërfaqe 6420 m² me kulturë oborr, ngastra nr.1260 me sipërfaqe 70 m², ngastra nr.1261 me sipërfaqe 28 m² dhe ngastra nr.429 Zona kadastrale Deçan.

II.

Në ngastrat e cekura më lartë me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, parashihet që të ndërtohen objekte të larta për banim dhe afarizëm me qëllim të përfitimit publik.

III.

Me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të ngastrave të cekura më lartë, marrësi i tokës në shfrytëzim duhet t'i përmbahet Planit Urbanistik.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi dhe për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite autorizohet Komisioni Komunal i formuar në Asamble, sipas të gjitha Ligjeve në fuqi.

V.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Asambleja komunale në Deçan.

VI.

Me nga një kopje të Vendimit do të paisen: Komisioni Komunal i formuar në Asamble dhe Arkivi Komunal.

01.Nr.V-6

Deçan, dt.27.05.2015

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit

Jashar Dobraj

HYRJE-BLATA-KOSOVË
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANI - DECAN MUNICIPALITY

Nga: K K Deçan AS Nr. Prot: 11767
Data: 27.05.2015

Nr. i faqeve: 01 Data: 27.05.2015
No. i faqeve: 01 Data: 27.05.2015

DEÇAN DECANI